



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2020

**Lënda:           Përgjigje kërkesë për informacion**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
**Rruga: \_\_\_\_\_, Tiranë**

**e.mail: \_\_\_\_\_**

Në vijim të kërkesës suaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me e.mail dhe regjistruar me nr.6571 prot., datë 12.05.2020, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion, ju bëjmë me dije se:

Bashkia Shkodër, realizimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, e kryen me sipërmarrje private. Proçedura e prokurimit publik zhvillohet e hapur, dhe në 2019 është zhvilluar proçedurë prokurimi për shërbimin e pastrimit.

Në njësitë administrative në zonat rurale, Bashkia Shkodër e ofron shërbimin e menaxhimit të mbetjeve me frekuencat e percaktuara në kontratë për evadimin e mbetjeve, kontratë e lidhur me sipërmarrës privat.

Sipërfaqja e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër për qytetin është 100%, ndërsa në njësitë administrative rreth 85%.

Informacion për shërbimin e pastrimit mund të gjeni në faqen web të Bashkisë Shkodër, duke klikuar tek Transparenca e Buxhetit, në zërin shpenzime, tek Menaxhimi i mbetjeve duke përzgjedhur dhe vitin që ju nevitet ose në <https://buxheti.info/shkoder/>

Shërbimi i transportit publik, ofrohet me operator privat. Për vitin 2019 nuk ka patur proçedurë tenderimi për shërbimin e transportit publik.

Për më shumë informacion, mund të shikoni përgjigjen nr.66 tek Programi i Transparencës [http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Regjistri\\_i\\_kerkesave\\_dhe\\_pergjigjeve\\_2019\\_1556\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Regjistri_i_kerkesave_dhe_pergjigjeve_2019_1556_1.php)

Realizimin e buxhetit mund ta gjeni duke klikuar në [http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Raportime\\_1048\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Raportime_1048_1.php)

Bazuar në VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, numri i ditëve për paisje me leje ndërtimi është 60.

Hapësira e gjelbër publike në zonën urbane e mirëmbajtur nga Bashkia Shkodër ka një sipërfaqe prej 121 500 m<sup>2</sup>.

Për më shumë informacion, mund të shikoni përgjigjen nr.28 tek Programi i Transparencës [http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Regjistri\\_i\\_kerkesave\\_dhe\\_pergjigjeve\\_2019\\_1556\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Regjistri_i_kerkesave_dhe_pergjigjeve_2019_1556_1.php)

Numri total i të punësuarve në Bashkinë Shkodër është 348.

Numri i kërkesave për strehim social është 458.

Në Bashkinë e Shkodrës janë 14 qendra shëndetësore funksionale, në të cilat marrin shërbim rreth 173029 individë. Pjesë përbërëse e këtyre qendrave shëndetësore janë edhe 65 ambulanca, të cilat ofrojnë shërbim për secilën lagje, të shtrira në qytet dhe njësitë administrative.

Përsa i përket numrit të klinikave private shëndetësore, numrit të mjekëve dhe ndihmësmjekëve për 1000 banorë dhe atyre të infermierëve ju lutem referojuni për informacion institucioneve përkatëse.

Duke ju uruar, mbarëvajtje në punë.

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**